# FUNKSIONI: MBROJTJA SOCIALE

## Programi 10661: Strehimi Social

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|---|---|
| | | |
| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
| 10661 | Strehimi social | • Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit;<br>• Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;<br>• Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore;<br>• Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë;<br>• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit;<br>• Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë;<br>• Perfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira; |

| Qëllimi i politikës | Objektivat Specifik | Treguesit/ Indikatori | Situata 2019 | Situata e synuar 2020 | Situata e synuar 2021 | Situata e synuar 2022 | Situata e synuar 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. | **O1.**Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevoje | Numri personave të mbështetur me strehim social sipas kategorive nga 1 tek 4 më poshtë (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar) | 20% | 0% | 0% | 0% | 0% |
| | | Numri i personave që kanë përfituar banesa sociale me kosto të ulët dhënë nga Enti i Banesave (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar) | 0% | 0% | 0% | 0% | 0% |
| | | Numri i familjeve qe perfitojne banesa sociale me qera (ndryshimi vjetor në %) | | | 20% | 0% | 0% |
| | | Numri i përfituesve të shërbimeve integruese të ofruara | Shërbime integruese dhe zhvilluese për rreth 50 jetimë dhe pjestarë të familjeve një prindërore të akomoduara në apartamente sociale funksionale dhe në administrim të Bashkisë së Shkodrës | Shërbime integrues edhe zhvilluese për rreth 60 jetimë dhe pjestarë të familjeve një prindërore të akomoduara në apartamente sociale funksionale dhe në administrim të Bashkisë së Shkodrës. | Sherbime integruese dhe zhvilluese per rreth 60 jetimë dhe pjestarë të familjeve një prindërore të akomoduara në apartamente sociale funksionale dhe në administrim të Bashkisë së Shkodrës. | Shërbime integruese dhe zhvilluese për rreth 60 jetimë dhe pjestarë të familjeve një prindërore të akomoduara në apartamente sociale funksionale dhe në administrim të Bashkisë së Shkodrës. | Shërbime integruese dhe zhvilluese për rreth 60 jetimë dhe pjestarë të familjeve një prindërore të akomoduara në apartamente sociale funksionale dhe në administrim të Bashkisë së Shkodrës. |
| | | Numri i apartamenteve sociale funksionale për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje; | 24 | 24 | 24 | 24 | 24 |
| | **O2.** Vlerësimi, planifikimi dhe | Numri i aplikimeve për bonus strehimi (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar. | 40% | 685% | 0% | 0% | 0% |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm | Numri i aplikimeve për banesa sociale (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar) | 33% | 400% | 0% | 0% | 0% |
| | | Numri i aplikimeve për banesa sociale me qira (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar) | 57% | 609% | 0% | 0% | 0% |
| | | Nr i aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit, | 1 | 6 | 6 | 6 | 6 |
| | | Nr i zonave të vlerësuara për zhvillim dhe pajisje me infrastrukturë me qëllim strehimin; | Zona të zhvilluara për strehim, zona të pajisur me infrastrukturë për ndërtimin e banesave sociale me kosto të ulët.; | Zona të zhvilluara për strehim, zona të pajisur me infrastrukturë për ndërtimin e banesave sociale me kosto të ulët.; | Zona të zhvilluara për strehim, zona të pajisur me infrastrukturë për ndërtimin e banesave sociale me kosto të ulët.; | Zona të zhvilluara për strehim, zona të pajisur me infrastrukturë për ndërtimin e banesave sociale me kosto të ulët.; | Zona të zhvilluara për strehim, zona të pajisur me infrastrukturë për ndërtimin e banesave sociale me kosto të ulët.; |
| | | Nr. i strehave të përkohshme të ngritura për komunitetin romë/egjiptian; | Vlerësim i nevojave dhe planifikim i ngritjes së një strehe të përkohshme për komunitetin romë dhe egjiptian; | Vlerësim i nevojave dhe planifikim i ngritjes së një strehe të përkohshme për komunitetin romë dhe egjiptian; | Vlerësim i nevojave dhe planifikim i ngritjes së një strehe të përkohshme për komunitetin romë dhe egjiptian; | Vlerësim i nevojave dhe planifikim i ngritjes së një strehe të përkohshme për komunitetin romë dhe egjiptian; | Vlerësim i nevojave dhe planifikim i ngritjes së një strehe të përkohshme për komunitetin romë dhe egjiptian; |
| | | Nr. i banesave në rrezik shembje të përmirësuara; | 30 | 40 | 50 | 50 | 50 |
| | | Nr. i banorëve përfitues; | 3000 | 3000 | 3000 | 3000 | 3000 |
| | | Nr. i familjeve përfituese; | 673 | 673 | 673 | 673 | 673 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr. i banesave sociale me qira 2+1 dhe 1+1 (kontenier);<br>Nr. i familjeve përfituese;<br>Nr. i përfituesve: | 27 banesa sociale me qira (me kontenier 2+1 dhe 1+1); rreth 33 familje rome përfituese; rreth 142 përfitues. | 27 banesa sociale me qira (me kontenier 2+1 dhe 1+1); rreth 33 familje rome përfituese; rreth 142 përfitues. | 27 banesa sociale me qira (me kontenier 2+1 dhe 1+1); 28 apartamente; rreth 33 familje rome përfituese+28 familje; rreth 288 përfitues. | 27 banesa sociale me qira (me kontenier 2+1 dhe 1+1); 28 apartamente; rreth 33 familje rome përfituese+ 28 familje; rreth 288 përfitues. | 27 banesa sociale me qira (me kontenier 2+1 dhe 1+1); 28 apartamente; rreth 33 familje rome përfituese+28 familje; rreth 288 përfitues. |

| Të dhënat e programit / Vitet | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. të strehuarve në vit; | 50 | 60 | 60 | 60 | 60 | 60 |
| Numri i apartamenteve sociale funksionale për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje; | 24 | 24 | 24 | 24 | 24 | 24 |
| Nr. i aplikimeve pranë Bashkisë për bonus strehimi | 5 | 7 | 55 | 55 | 55 | 55 |
| Numri i aplikimeve gjithsej ne vite për banesa sociale me kosto të ulët | 15 | 20 | 100 | 100 | 100 | 100 |
| Numri i aplikimeve për banesa sociale me qera | 7 | 11 | 78 | 78 | 78 | 78 |
| **Numri i aplikimeve gjithsej ne vite për strehim social** | **2006** | **2044** | **2277** | **2510** | **2743** | **2976** |

| **Projekte të rëndësishme** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kodi projektit** | **Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit** | **Buxheti 2021 (mijë lekë)** | **Buxheti 2022 (mijë lekë)** | **Buxheti 2023 (mijë lekë)** |
| P10661.O1.A1 | Administrimi i banesave sociale me qira të ngritura pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6.dhe ofrimi i shërbimeve integruese & zhvilluese | 1,154 | 1,150 | 1,150 |
| P10661.O2.A1 | Zbatimi i programeve të strehimit social | 600 | 600 | 600 |
| P10661.O2.A2 | Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komunitete ve të pafavorizuara | | | |
| P6190.O2.A3. | Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare) | 25,000 | 27,023 | |

| Informacion financiar | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Vitet** | **Viti 2018** | **Viti 2019** | **Viti 2020** | **Viti 2021** | **Viti 2022** | **Viti 2023** |
| Tavani i përgjithshëm i programit | | | | 26,754 | 28,773 | 1,750 |
| Shpenzimet bruto | 7,933 | 7,752 | 95,579 | 26,754 | 28,773 | 1,750 |
| Të ardhurat e programit | 7,933 | 7,287 | 59,689 | 25,818 | 27,023 | - |
| Shpenzimet neto | - | 465 | 35,890 | 936 | 1,750 | 1,750 |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | | - | - | - |
| Investimet kapitale | | | | 25,000 | 27,023 | - |

**Komente**

**Programi 10661: Strehimi social** ka si burim financimi kryesisht transferten e kushtezuar per vitet 2018-2022 dhe te ardhurat e bashkise. Ne vitin 2021 kemi trashegimi me destinacion ne shumen 818 mije leke qe vijne nga gjendja e vitit 2020 qe do perdoret per vinin 2021. Per vitin 2023 kemi burim financimi vetem te ardhurat e veta. Pjesen me te madhe te shpenzimeve e zene shpenzimet kapitale me rreth 93.4% ne vitin 2021, 93.9% ne vitin 2022 dhe 0% ne vitin 2023. Shpenzimet korrente zene 6.6% per vitin 2021, 6.1% per vitin 2022 dhe 100% per vitin 2023.

| Nr. 01 | **Projekti: P10661.O1.A1**<br>Administrimi i banesave sociale me qira të ngritura pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6.dhe ofrimi i shërbimeve integruese & zhvilluese | **Funksioni: 10** Mbrojtja Sociale<br>**Llojet e programit: 10661** Strehimi Social |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i.Situata**

Në bazë të Marrëveshjes së bashkëpunimit që Bashkia Shkodër ka lidhur me Ministrinë e Zhvillimit Urban, është realizuar rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës pyjore me qëllim përshtatjen në banesa sociale me qira për strehimin e jetimëve që kanë dalë nga institucionet e përkujdesit shoqëror dhe aktualisht jetojnë në konviktet e qytetit si dhe familjeve me një prind që ndodhen në situatë të vështirë social-ekonomike.

Për të filluar zbatimin e programeve të strehimi social, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat synojnë rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë gjatë zbatimit të programeve të strehimit social.

Me vendim nr. 27 datë 26.6.2020, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banesave Sociale me Qira pranë Qendrës Komunitare "Për familjen" nr. 6", është miratuar Rregullorja për funksionimin e këtij programi të strehimi, me qëllim rregullimin e marrëdhenieve dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet përfituesvë dhe strukturës përgjegjëse administruese. Pjesë integrale e kësaj Rregulloreje janë :

Aneksi i - "Kontrata e dhënies me qira të banesave sociale pranë Qendrës Komunitare nr. 6";
Aneksi II - "Norma Detyruese, Rregulla të përgjithshme të marrëdhënieve ndërmjet përfituesve të banesave sociale me qira".
Gjithashtu me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.14 datë 26.2.2020 "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale tek ish Konvikti i shkollës pyjore„ janë miratuar vlerat e qirasë mujore sipas sipërfaqeve të apartamenteve në këtë strukturë.

Për këtë program kanë aplikuar 30 aplikues, nga të cilët 16 aplikues kanë plotësuar kriteret për këtë program dhe janë kualifikuar në fazën e dytë (një aplikues është tërhequr nga proçesi). Aplikuesit e tjerë janë orientuar drejt programeve të tjera të strehimit që Bashkia Shkodër po zbaton. Lista e përfituesve pasi është miratuar në Komisionin e Strehimit të Bashkisë është dërguar për miratim pranë Këshillit Bashkiak.

Në zbatim të këtij projekti janë rikonstrukturuar 24 apartamente të cilët do të jenë në dispozicion të këtij programi strehimi dhe të rasteve në kushtet e emergjencës për strehim apo raste që të dhunës që trajtohen me proçedurë të përshpejtuar sipas pikës 13 dhe 19 të VKM nr. 384 datë 12.6.2019 2019 "Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore„.

Në zbatim të nenit 33 të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social*", përcaktohet: "1.Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale. 2. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira"* .

Bashkia Shkodër do të vlerësojë në vazhdimësi nivelin e të ardhurave të përfituesve në raport me vlerën e qirasë për të siguruar që qiraja është e përballueshme për përfituesit. Në rastet kur vlera e qirasë zë një përqindje më të madhe se ajo e përcaktuar në ligj në raport me nivelin e të ardhurave e individit/familjes, do të relatojmë pranë Këshillit Bashkiak me synim perjashtimin e mundshëm nga pagesa e qirasë të individëve/familjeve qe kane te ardhura te pamjaftueshme

Sfida kryesore është që nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, të krijohet një mjedis mbështetës që do të ndihmojë dhe mbështesë për fuqizimin ekonomik, social dhe autonominë, këto shtresa vulnerabël që do të strehohen në këto banesa sociale.

**ii. Synimi i projektit**

- Përmirësimi i kushteve të banimit të jetimëvë që jetojnë prej shumë vitesh në konviktet e shkollave të mesme në Shkodër.
- Sigurimi i akomodimit të përshtatshëm të jetimëve që pas moshës 18 vjecare largohen nga institucionet e përkujdesit rezidencial.
- Mbështetja e jetimëve në përmirësimin e jetesës dhe socializimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të qendrës komunitare.
- Orientimin drejt programeve të tjera të strehimit në momentin që përfituesit arrijnë një fuqizim ekonomik dhe social të konsiderueshëm.
- Ofrimi i strehimi të rasteve në kushtet e emergjencës për strehim sipas parashikimeve ligjore.
- Përmirësimi i situatës socio – ekonomike të familjeve një prindërore, grave kryefamiljare me shumë fëmijë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Shpallja e thirrjes për aplikim të progamit dhe plotësim i formularëve të vetëdeklarimit
- Vlerësim dhe kualifikim i kërkesave sipas sitemit të pikëzimit dhe njoftimi i aplikuesve të kualifikuar.
- Njoftim i aplikuesve të kualifikuar për plotësim të dokumentacionit dhe Shqyrtim dhe verikim të aplikimeve nga Komisioni i strehimit.
- Dërgim per miratim të listës përfundimtare të përfituesve pranë Këshillit Bashkiak.
- Ngritja dhe vënia në funksion të qendrës komunitare me shërbime mbështetëse dhe integruese.
- Bashkëpunime dhe marrëveshja me OJF, institucione publike, biznes privat, në mbështetje të përmirësimit dhe integrimit social të përfituesve të këtij projekti.
- Ngritja e strukturës menaxhues dhe administrues të banesave sociale me qira.
- Subvencionimi i qirasë për individë/familje pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta.
- Akomodimi i përfituesve në banesat sociale.
- Fuqizimi socio-ekonomik i përfituesve me synim arritjen e autonomisë.

**b) Rezultatet që prisni**

- Të gjithë jetimët qe jetojnë në konvikte do të akomodohen në kushte të mira pranë banesave sociale me qira.
- Jetimet pas moshës 18 vjeçare, qe dalin nga institucionet e përkujdesit rezidencial do të kenë akomodim të siguruar dhe të përshtatshëm.
- Familje njëprindërore, nënat kryefamiljare me fëmijë në kushte të vështira ekonomike - sociale do të kenë më shumë mundësi integrimi dhe fuqizimi ekonomik.
- Rastet emergjente për strehim përfitojnë strehim të përshtatshëm.
- Shërbime individuale mbështesëse dhe integruese të krijuara dhe funksionale për të mundësuar integrimin e
- përfituesve.
- Qendër Komunitare funksionale dhe në shërbim të komunitetit për mbështetjen, integrimin dhe fuqizimin e kategorive dhe familjeve në vashtirësi socio-ekonomike.

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Jetimët që jetojnë në konvikte<br>Jetimët që dalin nga instituconet pas moshës 18 vjecare<br>Familjet njëprindërore, gratë kryefamiljare që jetojnë në kushte të vështira ekonomike e sociale<br>Komuniteti. | Bashkia Shkodër<br>OJF<br>Ministria e Financës dhe Ekonomisë<br>Institucionet publike në territor |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2021 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Ujë | **258** | | | 258 | | |
| A.2 | Energji elektrike | **596** | | | 596 | | |
| A.3 | Mirëmbajtje e zakonshme | **300** | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **1154** | | | **1154** | | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2022 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Ujë | **258** | | | 258 | | |
| A.2 | Energji elektrike | **592** | | | 592 | | |
| A.3 | Mirëmbajtje e zakonshme | **300** | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **1150** | | | **1150** | | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2023 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Ujë | **258** | | | 258 | | |
| A.2 | Energji elektrike | **592** | | | 592 | | |
| A.3 | Mirëmbajtje e zakonshme | **300** | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **1150** | | | **1150** | | |

| f) Periudha e zbatimit | g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| Janar – Dhjetor 2021 , 2022,2023 | -Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.<br>-Ministria e Financës dhe Ekonomisë<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.02 | **Projekti: P10661.O2.A1**<br>Zbatimi i programeve të strehimit social | **Funksioni: 10** Mbrojtja Sociale<br><br>**Llojet e programit: 10661** Strehimi Social |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Me miratimin e kuadrit të ri ligjor të strehimit social, gjatë vititi 2020, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë gjatë zbatimit të programeve të strehimit social.

Me datë 02.03.2020 është shpallur Thirrja për aplikime për tre programe të strehimit social: Subvencionimi interesave të kredisë, Banesa sociale me qira pranë Konviktit të ish Shkollës Pyjore dhe Subvencionimi i Qirasë në tregun e lirë, e cila është bërë publike në faqen zyrtare te Bashkisë. Për shkak të COVID-19 dhe në zbatim të VKM nr. 243, datë 24.3.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore„ proçedurat e aplikimit janë pezulluar dhe janë rihapur me datë 01.06 2020.

Gjatë vitit 2020 informacioni në lidhje me programet e strehimit në zbatim është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë si dhe janë shfrytëzuar mediat lokale për promovimin dhe shpërndarjen e këtij informacioni sa më shumë tek qytetarët. Gjithashtu specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qenë i gatshëm për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetaret, çdo ditë pranë zyrës me një ndalesë.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 42 datë 25.09.2020 "Për miratimin e Listës përfundimtaretë përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti për vitin 2020", është miratuarlistae parë me 81 përfitues për programin "Subvencionimi i nteresave të kredisë", e cila i është dërguar institucioneve financiare që do ta zbatojnë. Gjithashtu është miratuar nga Komisioni i Strehimit dhe dërguar për miratim pranë Këshillit Bashkiaklista plotësuese e përfituesve dhe masën e subvencionimit të intereve të kredisë për 23 përfitues në këtë program.

Gjithashtuështë miratuar nga Komisioni i Strehimit të Bashkisë Lista me 16 përfitues për programin "Banesa Sociale me qira pranë Qendrës komunitare "Për familjen nr. 6"dhe është dërguar për miratim pranë KëshillitBashkiak.Aktualisht po punohet për vlerësimin e aplikimeve dhe plotësimin e dokumentacionit për programin tjeter që po zbatohet nga Bashkia "Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë".

Një nga sfidat kryesore gjatë zbatimit të programeve të strehimit social mbetet administrimi dhe mirë menaxhimii i programeve të strehimit social.

**ii. Synimi i projektit**

- Përmiresimi i kushteve të strehimit për familjet e pastreha nëpërmjet harmonizimit dhe bashkërendimit më efikas të shërbimeve sociale në mbështetje të grupeve sociale më në nevojë.
- Bashkërendim dhe koordinim të afërt me qeverinë qendrore për zbatimin e projekteve të strehimit social me qëllim zbutjen e kësaj plage sociale.
- Vlerësimi i inventarit të aseteve e pronave të paluajtshme të Bashkisë së Shkodrës me objektiv kthimin e këtyre aseteve në banesa sociale.
- Përmirësimi i kushteve të jetesës për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë blerjen e shtëpive në treg të lirë, duke përfshirë kryesisht familjet në vështirësi të theksuara socio-ekonomike.
- Ofrimi i alternativave për një strehim të përballueshëm e të përshtatshëm.
- Administrimi i të dhënave aktuale e të sakta me qëllim hartimin e politikave efikase.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Shpallja e thirrjes për aplikim për programet që do të zbatohen dhe janë financuar.
- Plotësim i formularëve të vetëdeklarimit sipas programeve të strehimit.
- Vlerësim dhe kualifikim i kërkesave sipas sitemit të pikëzimit.
- Njoftim i aplikuesve që nuk kualifikohen për plotësim të të metave.
- Njoftim i aplikuesve të kualifikuar për plotësim të dokumentacionit.
- Shqyrtim dhe verikim të aplikimeve nga Komisioni i strehimit.
- Dergim per miratim të listës përfundimtare të përfituesve pranë K.B.
- Përcaktimi i listës së aplikuesve për strehim social sipas llojeve të aplikimit dhe të mundësive për të përfituar, banesë
- Përgatitjen e programit afat mesëm të strehimit social në Bashkinë e Shkodrës.
- Forcimi i kapaciteteve në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave e strehimit social.
- Përmirësim i qasjes në strehim të grupeve vulnerabël.

| b) Rezultatet që prisni | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ○ Shërbim i strehimit social i konsoliduar dhe efektiv.<br>○ Sigurimi i strehimit nëpërmjet zgjerimit e orientimit të programeve të strehimit social që zbatohen.<br>○ Informacion i plotë mbi nevojat për strehim social në Bashkinë e Shkodrës.<br>○ Strehimi social pjesë e shërbimeve sociale dhe e mbështetjes së familjeve në vështirësi ekonomike e sociale.<br>○ Lista e përfituesve të programeve të strehimit të zbatuar në bashki të miratuar në Këshillin Bashkiak<br>○ Gjendja e pronave dhe aseteve publike të vlerësuara dhe sipas mundësive të projektuara për strehim social. | | | | | | | |
| **c) Aktorët e mundshëm** | | | **d) Kontributet e mundshmenëprojekt** | | | | |
| Individë dhe familje në vështirësi ekonomike e sociale që nuk kanë të ardhura të sigurojnë strehim të përshtatshëm.. | | | Bashkia e Shkodrës<br>Donatorë vendas e të huaj,<br>OJF,<br>Ministria Financës dhe Ekonomisë<br>Enti Kombëtar i Banesave. | | | | |
| **e) Shpenzimet e llogaritura** | | | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2021** | | **Totali ( mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë | 600 | | | | 600 | |
| | **Shuma** | **600** | | | | **600** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | **Totali ( mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë | 600 | | | | 600 | |
| | **Shuma** | **600** | | | | **600** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2023** | | **Totali ( mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë | 600 | | | | 600 | |
| | **Shuma** | **600** | | | | **600** | |
| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>Janar – Dhjetor 2021, 2022, 2023 | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br><br>-Drejtoria e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik<br>- Ministria e Financës dhe Ekonomisë<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër | | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| Nr. 03 | **Projekti: P10661.O2.A2**<br>Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara | **Funksioni: 10** Mbrojtja Sociale<br><br>**Llojet e programit: 10661** Strehimi Social |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Me synim ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës, Bashkia e Shkodrës ka ndërmarrë një sërë nismash të rëndësishme: Gjatë vitit 2016 Bashkia e Shkodrës ka aplikuar dhe fituar pranë MZHU projektin për rikonstruksionin e 9 banesave të komunitetit egjiptian duke siguruar kështu financimin e duhur për rikonstruksionin e këtyre banesave në lagjen përtej urës së Bunës, gjithashtu është aplikuar për rikonstruksionin e 35 banesave të tjera pranë këtij komuniteti, por ky projekt nuk është miratuar. Është vënë në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave një sipërfaqe prej 66,000 m2 truall për ndërtimin e banesave sociale me kosto të ulët. Gjatë vitit 2017 kanë përfunduar ndërhyrjet për sigurimin e ujit të pishëm dhe administrimin e ujërave të zeza. Përfitues të këtij shërbimi janë 150 familje të komunitetit përtej urës së Bunës.

Gjatë vitit 2018 – 2019 është siguruar financimi, ka filluar zbatimi dhe është relizuar projekti: "Përmirësim i sherbimevebazenëlagjen Mar Lula (Ndërtimrrjeti i ujittëpijshëm). Nga zbatimi i këtij projekti kanë përfituar rreth 3000 banorë të lagjes "Mar Lula", ngatë cilët 100 janë pjesë e komunitetit rom.

Gjatë vitit 2019 është aplikuar pranë Ministrisë së linjës dhe ka filluar zbatimi i projektit "Godina sociale, Shkodër", që synon përmirësimin e kushteve të banimit për 27 familje të komunitetit rom, projekti pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2020, për të vijuar me proçedurat administratitive për miratimin dhe sistemimin e familjeve përfituese në këto godina.

Gjatë vitit 2020 bashkia Shkodër ka përfituar fonde nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë për financimin e projektit të rikonstruksionit të konviktit të ish shkollës Veterinare dhe përshtatjen e këtij objekti në fondin e strehimit social me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit për komunitetin, ku është parashikuar të rikonstruktohet 28 banesa, projekt i cili është në fazën e prokurimit dhe shumë shpejt do të fillojë zbatimi i tij.

Në vijim synohet që të projektohen dhe të aplikohet për fonde në ministrinë e linjës ose në bashkëpunim me sektorin privat për projekte që kanë lidhje me programin e zhvillimit të zonës me qëllim strehimin, pajisja e truallit me infrastrukturë në zona të palegalizuara e që nuk mund të legalizohen, në zonat e vjetra industriale jofunksionale etj.

Projektimi dhe sigurimi i financimit për ngritjen e strehave të përkohshme për persona të pastrehë, që banojnë në mjedise që nuk kualifikohen si vende për banim në troje publike të evidentuara me qëllim strehimin, kryesisht për komunitetin rom/egjiptian.

Evidentimi i banesave private në rrezik shembje, dhe përgatitja e projekteve për përshtatjen dhe përmirësimin e kushteve të banesave për familje dhe individë të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.

**ii. Synimi i projektit**

- Përmirësimi i kushteve të banimit dhe të jetesës së komuniteteve të pafavorizuara në Bashkinë e Shkodrës.
- Projektimin e realizimin e ndërhyrjeve për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi, pajisja e truallit me infrastrukturë.
- Rikonstruksion i objekteve në pronësi të bashkisë të dala jashtë funksioni dhe kalimi në fondin e banesave sociale me qira.
- Përmirësimi i kushteve të banimit për familje dhe individë që banojnë në banesa në rrezik shembje.
- Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin romë/egjiptianë që jetojnë në banesa të papërshtatshme.
- Ndërthurja e programeve sociale të strehimit dhe shërbimeve sociale

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Evidentim dhe vlerësim i nevojave për zhvillim të zonës me qëllim strehimin.
- Projektimi dhe aplikim për sigurim të fondeve për financimin e projekteve për zhvillim të zonës me qëllim strehimin dhe/ose pajisja e truallit me infrastrukturë.
- Projektimi i ndërhyrjeve për rikonstruksion i objekteve në pronësi të bashkisë të dala jashtë funksioni dhe kalimi në fondin e banesave sociale me qira.
- Evidentim dhe vlerësim i nevojave për ngritjen e i strehave të përkoshme për komunitete në nevojë.
- Projektim, sigurim i financimit dhe ngritja e strehave të përkoshme për komunitete në nevojë.
- Evidentimi i banesave në rrezik shembje, përgatitja e projekteve teknike dhe sigurimi i financimit për përmirësimit të kushteve të banesave.

**b) Rezultatet që prisni**

- Zona të zhvilluara për strehim, truall i pajisur me infrastrukture për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara.
- Objekte në pronësi të Bashkisë Shkodër të dala jashtë funksionit janë pjesë e fondit të banesave sociale me qira.
- Streha të përkoshme të ngritura për komunite në nëvojë.
- Kushte të përmirësuara të banimit të individë / familje që banojnë në banesa në rrezik shembje.
- Fuqizimi social ekonomik të individëve/familjeve të pafavorizuara.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuniteti i Bashkisë Shkodër<br>Komuniteti rom/ egjiptianë. | | | Ministria e linjës<br>Bashkia<br>OJF,<br>Donatorë,<br>Qendra komunitare “Për familjen” | | | | |
| **e) Shpenzimet e llogaritura** | | | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2021** | | **Totali<br>( mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | **Totali<br>( mijë lekë)** | Nga kjo: | | | | |
